



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:167920

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06288258

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.127/2023

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm Penal, me pjesëmarrjen e gjyqtares së vetme gjykuese Sabrije Rraci, dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Fatmire Elezaj, në lëndën penale kundër të pandehurit: H B nga fsh.D- K.Klinë, për shkak të veprës penale: “Vjedhje e Shërbimeve” nga neni 314 par 1. të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.862/2023 të dt.31.07.2023, duke vendosur mbi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në bazë të nenit 495 të KPPK-ës jashtë shqyrtimit gjyqësor më dt.11.10.2024, ka marrë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: H B i lindur me dt. nga fsh.D- K.Klinë, ku edhe tani banon, i biri i M dhe nënës Gje vajzërisë G, i martuar ka të kryer shkollën fillore,, me profesion pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me nr. personal i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjer më datën 11.11.2022 në fsh.D-K. Klinës, përmes mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që, i pandehuri në shtëpinë e tij në adresën e lartcekur, devijon energjinë elektrike jashtë

njehsorit elektrik me shifrën DPE dhe energjia e shpenzuar përmes këtij kabulli nuk regjistrohet fare, për çka kompaninë KEDS e dëmton në vlerë prej 304,78 Euro.

Me çka ka kryer veprën penale „Vjedhje e Shërbimeve” nga neni 314 par 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Pranohet: kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.862/2023 të dt.31.07.2023.

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, nenit 46, 73, 74 dhe nenit 314 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurit ia shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I.Në lartësinë prej 100 (njëqindë) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë dënimi me gjobë të pandehurit i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

III.Urdhërohet i dënuari H B që emër të shpërblimit të dëmit t'i paguaj të dëmtuarës KEDS shumen në lartësi prej 304,78 € (treqindë e katër euro e shtatëdhjetë e tetë cent) afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

IV.Detyrohet: i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.862/2023 të dt.31.07.2023 , kundër të pandehurit: H B nga fsh.D-K.Klinë, për shkak të veprës penale: ‘Vjedhje e Shërbimeve’ nga neni 314 par 1. të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

PTH në Pejë, ka bërë kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me nr.PP/II.nr.862/2023 të dt.31.07.2023,kundër të pandehurit të lartëcekur për veprën vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1. të KPRK-së, duke propozuar që të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata gjatë vlerësimit të kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor ka vlerësuar se kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimorë është e bazuar.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtarja e vetme gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë siq janë provat materiale si kallëzimin penal, Procesverbali nr., i datës 11.11.2022;

Fotografite nga vendi i ngjarjes; dhe Pro-fatura mbi dëmin e shkaktuar me nr. , e datës 14.11.2022.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje të thellë se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë më nenin 41 të KPRK-së, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit, shkallen e rrezikshmërisë shoqërore, dhe ne këtë mënyrë do te ndikoj ne arritjen e qëllimit të dënimit, si mase për parandalimin e te pandehurit por edhe si mase për parandalimin e te pandehurit dhe personave

te tjerë kryes potencial te veprës penale nga kryerja e veprës penale ne te ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë vepër penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe par.2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË- DEGA NË KLINË

Departamenti i Përgjithshëm – Penal

P.nr.127/2023 me dt.11.10.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Fatmire Elezaj

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtiminë afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit kësaj Gjykate, në të kundërtën po që se i pandehuri nuk ushtrojnë kundërshtim, aktgjykimi do të marrë formën e prerë.